

EC

MA NDRYSHE

HULUMTIM

TURIZMI RURAL NË RAJONIN JUGOR TË KOSOVËS



PRILL 2023

HULUMTIMI I TURIZMIT RURAL NË RAJONIN JUGOR TË KOSOVËS

AUTOR: GRAMEN TARAKU

BOTUES: EC MA NDRYSHE

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &
Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7, Prishtinë

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org

029 222 771 & 038 224 967

Ky hulumtim është realizuar nga EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “Zbatimi i programeve të strategjisë të EC” i përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ‘EJA Kosovë’, bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.

PËRMBAJTJA:

1

Përmbledhje e përgjithshme nga Hulumtimi i Turizmit Rural në Rajonin Jugor të Kosovës

2

Qëllimi i hulumtimit

3

Metodologjia

4

Përparësitë e Rajonit - Gjetjet nga hulumtimi

5

Sfidat dhe mangësitë për zhvillimin e turizmit rural - Gjetjet nga hulumtimi

6

Analiza e Situatës në Rajonin Jugor të Kosovës

7

Legjislacioni

8

Potencialet për zhvillim të turizmit rural në rajonin jugor të Kosovës

9

Analiza SWOT zonës agroturistike dhe turistike në Rajonin Jugor të Kosovës

10

Zonat me potencial për zhvillim të turizmit në rajonin jugor të Kosovës

11

Sharri

12

Produktet turistike të Sharrit

13

Suhareka

14

Mamusha

15

Prizreni

16

Malisheva

17

Dragashi

18

Zhvillimi i produkteve tjera turistike

19

Konkluzionet, vështrimet dhe rekomandimet

20

Hapat për t'u ndërmarrë në të ardhmen

21

Për EC-in

1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME NGA HULUMTIMI I TURIZMIT RURAL NË RAJONIN JUGOR TË KOSOVËS

Ky raport hulumtues mbi turizmin rural në rajonin jugor të Kosovës paraqet të dhëna të konsoliduara nga puna hulumtuese dhe është mbindërtuar me informatat e nxjerra nga dokumente të ndryshme për secilën komunë në rajonin jugor të Kosovës: më saktësisht për Komunën e Prizrenit, Dragashit, Malishevës, Suharekës, Rahovecit dhe Mamushës.

Raporti paraqet një analizë të situatës aktuale dhe flet për potencialet natyrore dhe kulturore, për zhvillimin e turizmit rural dhe agro-turizmit në pjesën jugore të Kosovës duke u fokusuar në analizën e gjendjes së legjislacionit në Kosovë dhe teknologjisë, identifikimin e produkteve të reja turistike dhe agro-turistike inovative dhe unike për zonën. Në raport përfshihet gjithashtu edhe një analizë e gjerë (SWOT) e zonës me fokus në zhvillimin e produkteve të reja lidhur me turizmin rural dhe agro-turizmin, si dhe pjesa e fundit e këtij hulumtimi paraqet përfundimet e nxjerra dhe jep rekomandime për të ardhmen e turizmit rural në rajonin jugor të Kosovës.

Në përgjithësi, turizmi është një industri e madhe nga e cila drejtohen ekonomitë e shumë shteteve në botë. Gjatë viteve të fundit, turizmi në Kosovë është bërë një sektor i rëndësishëm i

ekonomisë që sjell të ardhura të konsiderueshme, duke u bërë kështu një sektor premtues për të ardhmen e vendit që do të ndikojë në rritje të qëndrueshme ekonomike.

Megjithatë, turizmi rural mbetet sektor që mund t'i ofrojë shumë ekonomisë së vendit me produkte të ndryshme siç janë aktivitetet në ferma, bujqësi, tregtia me pakicë dhe shumicë të agrumeve të ndryshme duke krijuar vende të reja të punës, si dhe mundësi të reja biznesi duke përfshirë këtu mikpritjen, hotelerinë, ushqimin tradicional si dhe shërbime tjera që ndërlidhen me turizmin rekreativ siç janë tur operatorët dhe guidat turistike.

Pjesa e parë e hulumtimit paraqet një përmbledhje të përgjithshme të potencialit, thekson mangësitë si dhe nevojat për zhvillim në të ardhmen, duke përfshirë objektivat dhe qëllimin e hulumtimit, me një prezentimin të shkurtër të konceptit të turizmit rural dhe aktiviteteve të tij. Poashtu, tek pjesa e parë e raportit, bëhet një përmbledhje e përgjithshme e analizës së situatës në regjionin perëndimor duke përfshirë edhe shqyrtimin e faktorëve socio-ekonomik, politik, ligjor, teknologjik dhe mjedisor si dhe një SWOT analizë më të përqendruar agro-turistike.

Pjesa e dytë e hulumtimit përqendrohet në një prezantim të potencialeve turistike individualisht për secilën komunë të rajonit jugor të Kosovës, analizimin e kërkesave për zhvillim të turizmit rural, nevojave logjistike, zgjidhjeve optimale duke përfshirë edhe analizën e rrugëve zhvillimore në të ardhmen, si dhe identifikimin e mundësive për partneritete në menaxhimin e turizmit.

Pjesa e tretë e raportit paraqet një ndarje të përfundimeve, rekomandimeve dhe hapave të mëtutjeshëm që duhen marrë në këtë proces.

Raporti poashtu sugjeron, bazuar në praktikën e mira të shteteve tjera, që ndërmarrjet mikro dhe të vogla që ofrojnë shërbime në bujtina familjare (B&B) dhe restorane duhet përkrahur, në mënyrë që të promovohet një zhvillim i qëndrueshëm i turizmit rural, eko-turizmit dhe agro-turizmit, por nuk përjashton komplekse të mëdha turistike të ndërlidhura me turizmin dimëror në lokacione të përshtatshme malore në rajon, si shembulli i Bjeshkëve të Sharrit.

Më tutje, ky raport hulumtimi sugjeron se ekzistojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit rural në rajonin jugor të Kosovës duke u bazuar në trashëgimi natyrore dhe kulturore që janë tipare dhe karakteristika të rajonin jugor.

Ky rajon ka një vlerë të shtuar për zhvillimin e mëtutjeshëm të turizmit rural gjatë gjithë vitit, gjatë periudhës dimërore dhe verore, duke ofruar produkte të reja turistike si dhe aktivitete të ndryshme në natyrë, duke përfshirë edhe ato sportive dhe rekreative, shërbime shëndetësore dhe me tipare shëruese, dhe duke promovuar eko-turizmin dhe agro-turizmin në veçanti.

Së fundmi, dokumenti jep rekomandime duke shqyrtuar praktikën e mira për zhvillimin e turizmit rural nga shtetet fqinje, lidhur me format e përkrahjes institucionale për zhvillim të turizmit, përmes themelimit të një organizate për menaxhimin të suksesshëm të destinacionit. Tutje, sugjerohet gjithashtu ndihma institucionale për themelimin e programeve dhe mbajtjen e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve teknike të shoqatave, operatorëve turistik dhe të ofruesve të shërbimeve hoteliere, në mënyrë që të zhvillohet dhe promovohet më mirë turizmi në rajon.

Ky raport hulumtues duhet të konsiderohet si një dokument punues dhe si i tillë do të inkurajojë vlerësimin, përkushtimin dhe bashkëpunimin nga institucionet relevante dhe akterët pjesëmarrës deri në kohën e aprovimit të tij.

2. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i këtij hulumtimi është të kontribuojë në promovimin, shfrytëzimin dhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm të potencialit të turizmit rural dhe agroturizmit në rajonin jugor të Kosovës më saktësisht në Komunën e Prizrenit, Dragashit, Malishevës, Suharekës, Rahovecit dhe Mamushës, përmes identifikimit të potencialit, nevojave dhe rekomandimeve për zhvillimin e produkteve të reja turistike dhe agroturistike në këtë rajon.

Për më tepër, gjetjet dhe rekomandimet nga ky hulumtim do të ndihmojnë në zhvillimin e strategjisë rajonale për turizmin rural dhe gjetjen e fondeve për zhvillimin dhe promovimin e produkteve të reja turistike në këtë rajon.

Natyra e këtij hulumtimi ka tipare gjeografike ku rajoni jugor përbëhet nga dominimi i zonave malore të Bjeshkëve të Sharrit, i cili njihet gjithashtu si "Rajoni Turistik i Alpeve Shqiptare" krahas katër rajoneve tjera turistike në Kosovë. Rajoni jugor i Kosovës poashtu ka karakteristika për zhvillimin e turizmit malor ndër-kufitar pasi që kufizohet me Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Raporti humlmtues paraqet një analizë të situatës aktuale dhe flet për potencialet natyrore dhe kulturore për zhvillimin e turizmit rural në pjesën jugore të Kosovës duke u fokusuar poashtu në analizën e gjendjes së legjislacionit në Kosovë, identifikimin e produkteve të reja turistike inovative dhe unike për zonën.

Ne raport përfshihet gjithashtu edhe një analizë e gjerë (SWOT) e zonës me fokus në zhvillimin e produkteve të reja turistike dhe agroturistike, si dhe pjesa e fundit e këtij hulumtimi jap konkluzione dhe rekomandime për të ardhmen e turizmit rural dhe agroturizmit në rajonin jugor të Kosovës.

3. METODOLOGJIA

Metodologjia e hulumtimit përmban metoda të ndryshme sasiore dhe kualitative të hartuara enkas për nevojat specifike të këtij hulumtimi. Mjetet vijuese janë përdorur për realizimin e këtij hulumtimi.

-Shqyrtimi i dokumenteve strategjike komunale dhe materialet tjera në lidhje me turizmin - nga departamentet përkatëse komunale: turizmi dhe zhvillimi ekonomik;

-Ligji nr. 04/L-176 për Turizmin

-Linku: [LIGJI NR. 08/L-074 PËR TURIZMIN \(rks.gov.net\)](https://rks.gov.net/LIGJI_NR_08/L-074_PËR_TURIZMIN)

-Programi për Zhvillim të Turizmit Rural të Kosovës (Masa 302- Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve 302.4. – Zhvillimi i turizmit rural);

Linku: [PZHR_2022_SHQIP.pdf \(mbpzhrks.net\)](https://mbpzhrks.net/PZHR_2022_SHQIP.pdf)

-Strategjia për Zhvillimit Rajonal për periudhën 2020-2030;

Linku: [SHQ-Strategjia për Zhvillim Rajonal-.docx \(live.com\);](https://live.com/SHQ-Strategjia_për_Zhvillim_Rajonal-.docx)

Informatat e zyrtarëve përkatës komunal dhe vrojtimit nga pyetësorët për çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e turizimit rural;

Linku: [2023\Docs 2023\Study ECMN\Final drafts\Pyetesori Komunal per Hulumtim ne Fushen e Turizmit Rural - FINAL.docx](https://2023\Docs\2023\Study\ECMN\Final drafts\Pyetesori Komunal per Hulumtim ne Fushen e Turizmit Rural - FINAL.docx)

-Ligji . 04/L - 087 për Bjeshkët e Sharrit:

Linku:<https://gzk.rks-ov.net/ActDetail.aspx?ActID=2866>

-Burime të ndryshme informative nga operatorët turistik;

-Dokumenti për zhvillimin e produkteve të reja turistike të realizuara nga programi PPSE në vitin 2018.

Linku:https://ppse-kosovo.org/file/repository/SWISS_PUBLIKIM_ENG_WEB.pdf

4. PËRPARËSITË E RAJONIT - GJETJET NGA HULUMTIMI

Zhvillimi i turizmit rural në rajonin jugor të Kosovës duhet të bazohet në pozitën gjeografike, potencialet dhe vlerat natyrore dhe kulturore të rajonit jugor dhe në përputhshmëri me ligjet ekzistuese të vendit. Poashtu, zhvillimi i turizmit duhet të bëhet në bazë të vendndodhjes strategjike përgjatë brezit kufitar me Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Rajoni jugor konsiderohet të ketë përparësi gjeografike me pasuri të shumta natyrore, trashëgimi kulturore, shtigje për ecje, mundësi për pushim dhe rekreacion etj.

Potencialet për zhvillim rural në këtë zonë përfshijnë turizëm gjatë gjithë vitit, siç ëshë turizmi malor veror, dimëror-sportiv (ski, ecje). Këto përparësi i japin mundësi rajonit për investime të kombinuara në produkte të ndryshme siç është rekreacioni dhe turizmi shëndetësor dhe sportiv, turizmi alpin (ngjitje bjeshkëve dhe shkëmbinjve), turizmi kulinar (apo gastro), agro-turizmi, gjuetia dhe peshkimi, turizmi tranzit, etj.

Gjetjet e këtij hulumtimi për zhvillimin e turizmit rural në rajonin jugor të Kosovës tregojnë që produktet e turizmit rural janë të bujshme dhe veçohen si në vijim:

- Akomodimi (qëndrim për pushime në bujtina dhe shtëpi private, hotele) duke ofruar shërbimin fjetje dhe mëngjes i njohur nga gjuha angleze si Bed & Brekafast (B&B);
- Turizmi dimëror në rajon (siç janë qendrat e skijimit dhe infrastruktura e tyre përcjellëse);
- Turizmi gastro i kombinuar me ecje në natyrë dhe ngjitje në bjeshkë;
- Rekreacion në natyrë, piknik në ferma, gjueti, peshkim, etj.;
- Ngjarje argëtuese siç janë festivalet, panairët dhe ngjarjet tjera relevante;
- Programe edukative në turizmin rural dhe aktivitete tjera siç janë mbledhja e frutave të malit (manave dhe kërpudhave), barishtave për çaj, bimëve mjekësore, vizitat në ferma lokale, bërjen e djathit dhe verërave, bletari, peshkimi, kampimi dhe ecjet rekreative.

Produktet agro-turistike të identifikuar në rajonin jugor të Kosovës përfshijnë në masë të madhe këto:

- Fermat/blegtoaria;
- Produktet nga qumshti (bylmeti);
- Frutat e imëta;
- Përpunimi i mjaltit;
- Çajërat,
- Bimët mjekësore;
- Turizmi (bujtina, restorane, hotele etj);
- Trashëgimia natyrore dhe kulturore
Etj.

Më poshtë në raport janë paraqitur saktësisht zhvillimi i këtyre produkteve sipas potencialit dhe karakteristikave të secilës Komunë.

Rëndësi të veçantë për zhvillimin e turizmit malor dhe rural në rajonin jugor të Kosovës kanë Bjeshkët e Sharrit që përfaqësojnë një zinxhir malesh që shtrihen nga pjesa jugore e Kosovës dhe Maqedonisë veriperëndimore në Shqipërinë verilindore.

Ky zinxhir është rreth 80 kilometra i gjatë dhe 10 deri në 30 kilometra i gjerë. Malet e Sharrit janë të famshme për relievin e tyre të thyer dhe majat e larta malore. Aty gjenden gjurmë të epokës së akujve në formën e liqeneve të ngrira e të larta malore.

Metutje hulumtimi potencon se burimet e pasura natyrore me destinacione atraktive turistike sjellin një potencial të madh për zhvillim dhe do të promovohen si një projekt pilot për zhvillimin e turizmit rula në rajonin jugor të Kosovës.

Pasi që potenciali për zhvillimin e turizmit rural në rajonin jugor të Kosovës është i shpërndarë, propozohet që të bëhet grumbullimi i projekteve turistike bazuar në fshatra për vlerësim të mëtutjeshëm gjatë elaborimit të procesit të strategjisë regjionale për t'u hartuar një program i zbatueshëm për zhvillimin e turizmit rural.

Në mënyrë që të përkrahet zhvillimi i rajonin jugor të Kosovës, nevojiten investime në të ardhmen për zgjerimin e strukturave turistike si dhe sigurimi i përkrahjes së integruar për zonat rurale drejt zhvillimit të tyre ekonomik dhe social.

Zhvillimi i partneritetit publiko-privat do të ofrojë mundësi të reja për zhvillim të suksesshëm dhe menaxhim të duhur për zhvillimin e turizmit rural dhe njëherit një partneritet i tillë do të kontribuojë drejtpërdrejtë në zhvillimin e produkteve të turizmit rural, marketingut dhe shitjeve, hulumtimit dhe teknologjisë, përmirësimit të infrastrukturës dhe zhvillimit të burimeve njerëzore.

4. SFIDAT DHE MANGËSITË PËR ZHVILLIMIN E TURIZIMIT RURAL - GJETJET E HULUMTIMIT

Koncepti dhe Nocioni:

Turizmi rural nënkuptohet si një grumbull aktiviteteve që u ofrohen vizitorëve në natyrë ku ndërlidhen burimet natyrore, trashëgimia kulturore dhe pervoja tjera siç janë shëtitjet dhe aktivitetet tjera, vizitat tjera në fshatra ku vizitorët inkurajohen të marrin pjesë në aktivitetet tradicionale të fshatit dhe ndërlidhet me format tjera të turizmit siç është agro-turizmi dhe eko-turizmi.

Në rajonin jugor të Kosovës ka shumë monumente natyrore dhe kulturore, por jo të gjitha janë të eksploruara aq sa duhet dhe të prezantueshme në treg. Kjo rrjedh si rezultat i mungesës së planifikimit strategjik, dhe studimeve të fizibilitetit për zhvillimin e produkteve të reja turistike apo komercializimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si thesar për krijimin e të hyrave, si dhe mungesa e programeve edukative për ngritjen e kapaciteteve njerëzore, marketing dhe promovimi i pamjaftueshëm i produkteve turistike.

Rajoni ballafaqohet edhe me sfida tjera të ndryshme dhe në veçanti ndërlidhen me mungesën e infrastrukturës bazike në disa zona si:

rrugë, ujë të pijshëm, kanalizim, linja telefoni tokësore dhe mobile, internet, etj. në zonat rurale dhe malore të rajonit, si dhe mungesa e planifikimit hapësinor, mungesa e menaxhimit të mbeturinave, degradimi i pyjeve, dhe i trashëgimisë kulturore etj.

Këto mungesa si dhe mungesa e koordinimit të politikave të sektorëve tjerë me atë të turizmit rural, konsiderohen të jenë faktorët tjerë që ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit rural.

Mangësitë tjera koniderohen këto:

- Mungesa e evidentimit dhe inventarizimit të objekteve dhe hapësirave turistike, rekreative dhe pushimi;
- Shtigje të pamjaftueshme të sinjalizuara dhe mirëmbajtura për ecje, çiklizëm, kalërim etj.;
- Mungesa e infrastrukturës për rekreacion dhe sporte verore dhe dimërore në rajon (përveç skiliftit në Brod);
- Vetëdija e ulët për rolin dhe rëndësinë e turizmit si aktivitet relativisht i ri ekonomik dhe hezitimi për të akomoduar turistë në shtëpitë private në fshatra;
- Mungesa e mirëmbajtjes së rrugëve që nuk mbulohen nga shërbimet komunale etj.

Sa i përket nevojave tjera zhvillimore të burimeve njerëzore në sektorin e turizmit rural, edukimi dhe trajnimi i akterëve pjesëmarrës janë faktorë të rëndësishëm për zhvillim, gjersa ofrimi i ndihmës financiare për komunitetin rural/fermerët vendor dhe për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NVM) është i domosdoshëm për të përmirësuar kushtet e tyre të punës dhe për zhvillimin dhe diverfifikimin e produkteve turistike.

Tutje, investimet në zgjerimin e kapaciteteve akomoduese në bujtina, zhvillimi i produkteve të reja turistike me karakter unik dhe inovativ, sigurimi i makinerisë dhe paisjeve për ferma në zona rurale për prodhuesit vendor do të ndihmonte në përmirësimin e ofertës turistike, rritjen e nivelit të produktivitetit si dhe sigurinë dhe kualitetin e produkteve të tyre.

5. ANALIZA E SITUATËS NË RAJONIN JUGOR TE KOSOVËS

Rajoni Jugor përbëhet nga 6 komuna: Prizrenit, Dragashit, Malishevës, Suharekës, Rahovecit dhe Mamushës dhe sipas të dhënave zyrtare, rajoni jugor ka një popullësi prej 409,449 banorëve apo 22.76 % të popullsisë së përgjithshme të Kosovës të cilët janë të shpërndarë në sipërfaqe prej 2,015.01 km² apo 18.47 % të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës dhe ka 239 vendbanime. Rajoni jugor kufizohet me Shqipërinë në jugperëndim dhe Maqedoninë në juglindje.

Rajoni zhvillimor jugor ka një potencial të madh turistik që ende mbetet relativisht i pashfrytëzuar. Pozita specifike, gjeografike, pasuritë natyrore, shembuj të shumtë të trashëgimisë kulturore dhe historike, si dhe folklori i larmishëm, e bëjnë rajonin jugor një vend ideal për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Ekziston një potencial i madh për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit malor dhe kampimit gjatë fundjavave.

Zhvillimi i turizmit duke përfshirë turizmin rural mund të bëhet një burim i rëndësishëm i mirëqenies për një pjesë të popullsisë në rritje të rajonit. Ky rajon ka një potencial të madh turistik që ende mbetet relativisht i pashfrytëzuar.

Komuna e Prizrenit është një xhevahir i turizmit që përbën edhe njërin nga fushat e zhvillimit të komunës së Prizrenit.

Prizreni është një ndër qytetet strategjike turistike për vizitorë të huaj dhe vendor. Malet e Sharrit përmbajnë qindra metra të zonave të cilat nuk shfrytëzohen plotësisht dhe paraqesin potencial të madh për zhvillimin e turizmit dimëror.

Malet e Koretnikut dhe të Pashtrikut kanë potenciale të mëdha natyrore për zhvillimin e turizmit malor, si alpinizmi dhe gjuetia, sikurse dhe lumenjtë e shumtë në rajon që ofrojnë mundësinë e zhvillimit të sporteve ujore dhe të peshkimit. Festivalet dhe organizimet e ndryshme kulturore dhe artistike dhe panairë agro-biznesi janë tipike për këtë rajon dhe tërheqin shumë vizitorë vendor dhe të huaj.

Rajoni i Prizrenit është njëri ndër tri destinacionit e Kosovës me më së shumti vizitorë. Vlerësimet nga një anketë, e cila është zhvilluar nga PPSE-ja (2017), tregojnë se numri i vizitorëve me fjetje është rreth 80,000-100,000. Ata/ato qëndrojnë mesatarisht 1.7 natë. Ndonëse nuk ka të dhëna të sakta për vizitorët një ditor, sipas disa vlerësimeve të akterëve të turizmit në këtë Komunë, numri i tyre është diku rreth 150,000-200,000.

Volumi i rritur ne turizëm ndikon drejtëpërdrejtë në krijimin e të hyrave dhe rritjes ekonomike të vendit duke rritur punësimin ne zona rurale duke krijuar vende të reja të punës dhe mundësi të reja biznesi të tilla si hotelet dhe shërbimet e ushqimit, por edhe në shërbimet e mikpritjes dhe veprimtaritë rekreative. Poashtu, turizmi rural rrit mundësitë e karrierës për të rinjtë me mundësi për trainim dhe përfshirje të drejtëpërdrejtë në drejtimin e bizneseve të turizmit.

Sa i përket vendit të origjinës, nga regjioni dominojnë shqiptarët e Shqipërisë, përderisa nga vendet tjera përtej regjionit, dominojnë turqit dhe gjermanët. Duhet theksuar që në dy vitet e fundit është rritur ndjeshëm numri i aziatikëve.

Në këtë Rajon Ekonomik Jugor- janë 23,710 sipërmarrje të regjistruara, nga të cilat 20,500 janë biznese individuale, rreth 2076 janë kompani me detyrime të kufizuara dhe 390 ndërmarrje janë kompani aksione.

6. LEGJISLACIONI

Në Kosovë, një ndër sfidat dhe problematikat kryesore për zhvillimin e turizmit malor dhe rural mbetet implementimi i kufizuar legjislacionit si ai mjedisor, hapësinor, trashëgimisë kulturore, për parqet, etj. poashtu edhe mos definimi i planit hapësinor për zona të veçanta dhe zona të mbrojtura paraqet pengesë për zhvillimin e turizmit malor.

Mosrepsektimi i ligjit të natyrës, degradimi i pyjeve dhe menaxhimi i dobët i objekteve të trashëgimisë kulturore, dhe niveli i ulët i legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit janë faktorë që kanë ndikime negative në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

Kjo mungesë ka ndikuar që zonat rurale të mos kenë investime për të zgjeruar kapacitetet e akomoduese dhe ndërtimin e produkteve tjera turistike për të qenë më konkurrent në rajon me shtetet tjera të zhvilluara.

Përmirësimi i rregulloreve ligjore që rregullojnë biznesin e turizmit duke zhvilluar një kornizë ligjore cilësore dhe të harmonizuar do ndikojnë në menaxhim të suksesshëm të zhvillimit të turizmit.

Në këtë rast siç është Ligji për Turizmin 04/L-176, pastaj një tërësi ligjesh në fushën e mbrojtjes së mjedisit, natyrës dhe trashëgimisë kulturore për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e zonave turistike, Ligji për Parqet Kombëtare, Ligji për Planifikimin dhe Ndërtimin, etj.

Ligji nr. 04/L-176 për Turizmin

Me këtë ligj përcaktohet baza ligjore dhe korniza institucionale, parimet dhe rregullat për zhvillimin dhe promovimin e turizmit, vendosja dhe zhvillimi i standarteve të shërbimeve turistike.

Fushëveprimi: Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, personave fizik dhe juridik, vendor ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari turistike, përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjekteve pjesëmarrëse në fushën e turizmit në përputhje me standardet e përcaktuara më legjislacionin në fuqi.

Parimet e këtij ligji janë: efikasiteti ekonomik, investimi në fushën e turizmit, regjistrimin vullnetar, ruajtja e trashëgimisë kulturore, mbrojtja e ambientit, dhe mbrojtja e konsumatorit.

Ligji nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillim Rural

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i politikave për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Ky ligj përcakton objektivat, masat dhe programin e politikave të bujqësisë dhe të zhvillimit rural në bazë të Planit për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor. Me këtë ligj përcaktohen dispozitat për ofrimin e shërbimeve publike bujqësore, kërkimit dhe trajnimit profesional, bazën e të dhënave dhe informacionin në fushën e politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural.

Faktorët teknologjik luajnë një rol të rëndësishëm veçanërisht në zhvillimin e industrive të veçanta siç janë agro-turizmi dhe turizmi rural. Teknologjitë e reja informative paraqesin përparësi për qëllime hulumtuese, promovime të biznesit, marketingut dhe sigurojnë informata për publikun e gjerë për vendet turistike, ofertat turistike dhe çështjet dhe ngjarjet e ngjajshme agro-turistike.

Situata më alarmuese është ndotja nga hudhja e mbeturinave, sistemet e parregullta apo joekzistuese të kanalizimeve, degradimi i pyjeve dhe përdorimi jo i duhur i tokës bujqësore, ndërtimet ilegale afër zonave të mbrojtura natyrore (afër lumenjve) të cilat të gjitha mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në (mos) zhvillimin e agro-turizmit dhe turizmit rural pasi që janë të prirura të ndotin ambientin, tokën bujqësore, të mbjellurat, pemët dhe perimet, etj.

7. POTENCIALET PËR ZHVILLIM TË TURIZMIT RURAL NË RAJONIN JUGOR TE KOSOVËS

Në bazë të pozitës gjeografike, gjeomorfologjisë, klimës, pasurive natyrore dhe kulturore të mbrojtura me ligj në rajonin ekonomik perëndimor, si dhe në bazë të vendndodhjes strategjike në trekëndëshin kufitar, potenciale janë turizmi malor veror, dimëror-sportiv (ski, ecje me rrathë), kulturor, rural, rehabilitues dhe kurativë, ekskursionist rekreativ, alpin (ngjitje bjeshkëve dhe shkëmbinjve), fluturimi me parashutë, speleologji, gjueti dhe peshkim, konferencier, turizmi transit, etj.

Zinxhiri i ofruesve të shërbimeve turistike në rajon përbëhet nga ata direkt si ndërmarrjet e vogla dhe të mesme hoteliere dhe bujtina familjare që ofrojnë akomodim dhe ushqim respektivisht, operatorët turistikë (disa shoqata dhe agjensione turistike) si dhe individët si udhëzues, përkthyes.

Agjencitë turistike ofrojnë shërbime biletash për udhëtim tokësor dhe ajror jashtë vendi duke promovuar ofertat dhe paketat turistike të huaja. Indirekt në industri përfshihen shërbimet komunale, transporti publik, infrastruktura, prodhuesit dhe tregtuesit ushqimor, etj.

Një rol të rëndësishëm mbështetës dhe përfshirje direkte kanë zyrat informative turistike. Në rajon ekziston Zyra informative turistike komunale dhe mesatarisht të pajisura me materiale dhe informacion turistik.

8. ANALIZA SWOT ZONËS AGROTURISTIKE DHE TURISTIKE NË RAJONIN JUGOR TË KOSOVËS

Gjatë realizimit të këtij hulumtimi është bërë një analizë në sektorin e turizmit rural më e gjerë, por është bërë edhe një analizë më e fokusuar në fushën e agro-turizmit.

Këto dy SWOT analiza paraqiten më poshtë.

Agro-turizmi:

Përparësitë e rajonit jugor për zhvillimin e agro-turizmit.

- Burimet e pasura natyrore (ajri, ujrat dhe lumenjtë e pastër) ideale për mbajtjen e kafshëve, peshkim dhe bletari
- Rritja e produktivitetit agro-biznesor
- Aktraksionet e trashëgimisë kulturore
- Ushqimi dhe specialitetet tradicionale
- Klima e përshtatshme për agro-turizëm
- Frutat e malit (manat dhe kërpudhat)
- Bimët mjekësore dhe barishtat për çaj
- Vende të përshtatshme për ecje, piknik dhe kampim
- Interesimi i rinisë për turizëm rural

Mundësitë e rajonit jugor për zhvillimin e agro-turizmit:

- Programe për ndihmë financiare vendore dhe ndërkombëtare;
- Fonde trajnimi për ngritjen e aftësive profesionale për fermerët dhe ndërtimi institucional i kapaciteteve;
- Zhvillimi i sektorit të agro-biznesit (mishi, bulmeti, bletaria, verërat, etj.)

- Rritja e kërkesave ushqimore;
- Investimet nga diaspora;
- Privatizimi i tokës bujqësore;
- Ligji mbi qiradhënien e tokës;
- Partneriteti publiko-privat i zhvilluar;
- Përmirësimi i politikave tatimore;
- Zhvillimi i sektorit të energjisë së ripërtrishme;

Rreziqet e identifikuara në zhvillimin e agro-turizmit:

- Mungesa e vullnetit politik për të përkrahur investimet në bujqësi
- Mungesa e përkrahjes institucionale për të zhvilluar plane të zbatueshme zhvillimore
- Pamundësia e investimeve komunale në agro-turizëm rural
- Ndërtimet dhe prerja e drunjëve pa leje
- Mungesa e furnizimit me energji elektrike
- Ndotja e lumenjëve nga kanalizimet dhe mosmenaxhimi i mbeturinave
- Fermerët janë refuzues ndaj metodave prodhuese jo-tradicionale
- Përmirësimi i ngadaltë i politikave tatimore.

Turizmi Rural:

Përparësitë dhe mundësitë për turizmin rural – natyror:

- Pozita e mirë gjeografike e rajonit dhe në veçanti e Bjeshkëve të Sharrit dhe mundësi për zhvillim të turizmit malor gjatë sezonës së verës dhe dimrit për aktivitete në natyrë, pushim dhe rekreacion dhe sport;
- Burimet e pasura natyrore (ajri, ujrati dhe lumenjtë e pastër) ideale për zhvillim rural (ferma, bletari, peshkim, gjueti);
- Mundësi për investime të kombinuara në sport dhe rekreacion, turizëm shëndetsor me partnerët e turizmit dhe shëndetësisë (iniciativa të përbashkëta biznesi);
- Shtigje të shënuara për ecje, çiklizëm dhe kalërim;
- Peisazhi i maleve dhe fushës së rajonit të lidhura mirë me objektet e trashëgimisë kulturore si kalaja, muzetë, objektet e kultit, objektet tjera si ura guri, etj.;
- Mundësia e udhëtimeve në rrugët e vjetra tregtare në këmbë dhe me kuaj në rajon dhe përtej kufirit shtetëror me Shqipërinë dhe Maqedoninë;
- Qendra/pista të skijimit, shërbime pajisjesh dhe trajnim për skijim (teleferik, skilifti në Brod dhe Prevalle, Dragash;
- Rritja e interesimit të banorëve dhe ofrimi i shtëpive, kullave me/pa ushqim në Bjeshkët e Sharrit (B&B) si dhe përfshirja në jetën lokale sidomos në ambientet e fshatrave;
- Akomodim në hotele, motele, fshatra turistike si dhe vila në zona atraktive turistike;
- Mikpritja dhe ushqimi tradicional në zona rurale;
- Eksperiencë individuale, grupe dhe familjare në "eko" dhe "agro" turnetë e organizuara nga ofruesit e shërbimeve individuale dhe operatorët turistik të pakët në rajon;
- Aktivitete të llojit të veçantë gjatë vizitës/pushimit si çiklizëm, peshkim, ecje, vrapim dhe kalërim;
- Turne eksplorues dhe studimes të agrikulturës, mbledhjes së çajrave, frutave të malit, bimë mjekuese, etj.;
- Vende të përshtatshme për ecje, piknik dhe kampim;
- Kushtet e përshtatshme klimatike, siguria dhe afërsia territoriale me qendrat turistike;

Dobësitë dhe rreziqet për turizmin natyror rural dhe sportivo rekreativ;

- Implementimi i kufizuar legjislativ si ai mjedisor, hapësinor, trashëgimisë kulturore, për parqet, etj.
- Degradimi i trashëgimisë natyrore në rajon nga vetëdija e ulët mjedisore e popullatës dhe mos kujdesi dhe ekspertiza institucionale me interes kombëtar;
- Prerja e pyjeve, ndotja e ambientit, mungon ndarja që në burim e mbeturinave shtëpiake dhe komerciale, ripërdorimi, riciklimi dhe trajtimi adekuat i tyre në deponinë rajonale si dhe prania e deponive ilegale;
- Mungesa e trajtimit të ujërave të zeza familjare dhe veçanërisht industriale në rajon dhe ndotja e tokës dhe ujërave është faktor kërcënues për turizmin dhe mirëqenien në rajon;
- Trashëgimia natyrore e rajonit e jo mjaftueshëm e njohur në Evropë dhe botë;
- Shtigje të pamjaftueshme të sinjalizuara dhe të mirëmbajtura për ecje, çiklizëm, kalërim etj.;
- Mungesa e evidentimit dhe hartëzimit të objekteve dhe hapësirave turistike, rekreative dhe pushimi;
- Mungesa e infrastrukturës bazike si rrugë, ujë i pijshëm, kanalizim, linja telefoni tokësore dhe pa mbulim të mjaftueshëm telefonie mobile, internet, etj. në zonat rurale dhe malore të rajonit;
- Mungesa e transportit publik dhe lidhjeve transportuese;
- Vetëdija e ulët për rolin dhe rëndësinë e turizmit si aktivitet relativisht i ri ekonomik dhe hezitimi për të akomoduar turistë në shtëpitë private në fshatra dhe qytete;
- Masat institucionale, fondet dhe kapacitetet njerëzore për zhvillimin e turizmit në rajon janë përgjithësisht të kufizuara dhe niveli ndryshon nga njëra komunë në tjetrën;
- Infrastruktura dhe disa shërbime publike si mbeturinat jo të kënaqshme;
- Mungesa e mirëmbajtjes së rrugëve që nuk mbulohen nga shërbimet komunale;
- Mungesa e investimeve, kapaciteteve njerëzore dhe promovimit të produktit turistik;
- Niveli i pamjaftueshëm i kapacitetet njerëzore, angazhimeve institucionale dhe bashkëpunimi ndër-sektorial.

Përparësitë dhe mundësitë për turizmin kulturor;

- Zonat arkeologjike dhe trashëgimia arkitektonike e kullave, objekte të vjetra qytetare; objekte kulturi, ura të vjetra, etj.
- Historia, religjioni dhe objektet e kultit katolik, musliman, ortodoks;
- Veshjet kombëtare, zeje dhe artizanate si filigran, stoli, vegla, thurje dore, punime druri, metali e dheu si stoli, enë, si dhe përpunimi tradicional i gurit dhe drurit dhe ndërtimet e objekteve tradicionale;
- Trashëgimia e paprekshme si muzika, folklori burimor, festivale kulturore;
- Mikpritja, doket, zakonet, ritet dhe stili i jetës rural dhe urban;
- Trashëgimi i pasur etnografike dhe etnologjike në rajon;
- Tregjet e hapura tradicionale të ushqimeve, zejeve ofrojnë një eksperiencë unike të blerjes ;
- OJQ-të lokale dhe të huaja janë përfshirë në mënyrë më aktive në hulumtime dhe investime kulturore, ndërsa interesimi pronarëve privat, komuniteteve dhe institucioneve rritet;
- Krijimi i vendeve të punës përgjatë gjithë zinxhirit në turizëm;
- Përvoja e disa agjencive dhe bizneseve turistike në turizmin kulturor ndonëse e kufizuar është një potencial për tu zhvilluar tutje në rajon.

Dobësitë dhe rreziqet për turizmin kulturor:

- Vetëdija e ulët për trashëgiminë kulturore, potencialin e saj zhvillimor dhe mos përbushja e legjislacionit;
- Eksperienca e vogël e turizmit kulturor në rajon në përgjithësi, ndonëse trashëgimia kulturore (e prekshme dhe të pa prekshme) është e larmishme, promovimi i saj, tërheqja e turistëve për ta vizituar dhe ofrimi i shërbimeve turistike përbëjnë një sfidë;
- Hapja më adekuate e objekteve kulturore ndaj publikut dhe turistëve dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara, evitimi i barrierave fizike, gjuhësore, kulturore dhe konceptuale;
- Investime të pakta dhe të ngadalshme dhe ndonjëherë jo shumë strategjike në infrastrukturën turistike kulturor në rajon si p.sh. përqendrim në restaurim në vend konservimi, ngritje kapacitetesh njerëzore, etj.
- Numër i kufizuar i ciceronëve dhe udhëzuesve natyror dhe kulturor dhe mungesa e një mekanizmi ligjor për çertifikimin e tyre dhe përgatitjen e profileve tjera shërbyesish turistik;
- Kujdes i pa mjaftueshëm për zejet tradicionale. Në Pejë artizanatet në rrezik shuarje janë mbështetur përmes një programi subvencioni nga Komuna por kjo është e pa qëndrueshme;

- Promovimim dhe marketing i pakët dhe jo efektiv i trashëgimisë kulturore në vend dhe ndërkombëtarisht;
- Kujdes i pamjaftueshëm në ruajtje dhe mirëmbajtje të trashëgimisë kulturore, përfshirë varreza, objekte, etj.;
- Kufizimet në qasje për popullatën lokale (shumicë) për të vizituar monumentet e trashëgimisë kulturore në zonat e veçanta kulturore si kisha, manastire, etj. si dhe reagimet e banorëve për përfshirjen e tokave të tyre private apo të komunitetit brenda zonave të tilla ku zbatohen kufizime në shfrytëzim;
- Ndërtimet e egra në kontrast me mjedisin rrethues, planifikimet hapësinore, përcaktimet arkitekturale, etj. si dhe përdorim i materialeve jo tradicionale, jo natyrale dhe jo miqësore për shëndetin dhe mjedisin;
- Restaurimi i ngadalshëm i kullave dhe objekteve tjera kulturore, shumë nga to rrëzohen për mos kujdes dhe/apo mungesë fondesh familjare apo komunale;
- Vetëdije, eksperiencë dhe angazhim i ulët në bashkëpunim, investime dhe ofrim shërbimesh nga ana e pronarëve privat të objekteve kulturore të cilët përbëjnë një pjesë të madhe të këtyre objekteve dhe pritja e donacioneve gjithnjë në zvogëlim dhe mungesa e fondeve investuese në rajon dhe vend;
- Nivel i ulët i përfshirjes së komunitetit në shfrytëzimin e objekteve kulturore potencialisht të përdorshme për turizëm si dhe pritje të larta për fonde nga institucionet dhe donatorët.

9.ZONAT ME POTENCIAL PËR ZHVILLIM TË TURIZMIT NË RAJONIN JUGOR TË KOSOVËS

Resurset natyrore – turistike të rajonit jugor

Rajoni jugor i Kosovës i cili përfshinë komunat Dragash, Prizren, Rahovec, Mamushë, Malishevë dhe Suharekë konsiderohet zonë me resurse të shumta të cilat mund të përfshihen në konceptin turistik.

Ky koncept ende nuk është i pasuruar tërësisht me kulturën natyrore, hidrografike, sportive, etno-kulturore por edhe të asaj bimore, pasuri këto të cilat presin të eksplorojnë, të kategorizohen dhe të shfrytëzohen në mënyrën e duhur nga industria e turizmit vendor dhe ndërkombëtar.

Një pjesë e tyre janë përfshirë në pako turistike por kjo konsiderohet e pjesshme dhe e shkurtër në afatin kohor (sezone e shkurtër verore) gjë e cila na vë para një sfide tjetër të ri-organizimit turistik në raportin Institucione-Kompani dhe Subjekte të pavarura (OJQ).

Këto resurse në linja të përgjithshme duke u mbështetur në njohuritë tona nga terreni; shpalosja dhe përshkrim i shkurtër i tyre do të bëhet natyrshëm duke shkuar komunë pas komune, por edhe duke i prekur sipas renditjes dhe sezonës, pa u thelluar në shtjellime më të thella studimore sepse vet ideja është theksim i këtyre resurseve primare natyrore.

Prezanton zonën kryesore për vlera botanike, faunistike, ekologjike, turistike, rekreative, sportive, edukative dhe kulturore të Kosovës. Malet e Sharrit kanë diversitet biologjik mjaft të theksuar.

Flora dhe vegjetacioni është i pasur me lloje. Në mesin e këtyre llojeve 86 sosh, janë të deklaruara me rëndësi ndërkombëtare, 26 lloje janë të përfshira në "Listën e Kuqe" Evropiane të shtazëve dhe bimëve si të kërcënuara dhe 32 janë në "Listën e Kuqe" të bimëve të kërcënuara sipas IUCN - it.

Duke u bazuar në këto fakte mund të konsiderohet si qendër e jetesës së llojeve diversitare të Ballkanit dhe Evropës. Një pjesë e Maleve të Sharrit është shpallur Park Kombëtar në vitin 1986. Zona e mbrojtur me ligj ka sipërfaqe prej 39 000 ha dhe shtrihet në kufijtë e katër komunave : Prizren, Shtërpçë, Therandë dhe Kaçanik.

Sipas IUCN (Unionit botëror për Ruajtjen dhe Konservimin e Natyrës) Parku Kombëtar Malet e Sharrit është evidentuar në listën ndërkombëtare të zonave të mbrojtura.

Kreshta malore kryesore e saj është e gjatë 95 km, e kufizuar me një pjesë mali të lartë dhe me kreshta anësore të ndara me shumë ujëra rrjedhës të egër, përfshinë mbi 100 maja mbi 2.000 m, prej të cilave 30 maja janë mbi 2.500 m.

Në anën e masivit të Maqedonisë dominon Maja e Titos, kurse në anën tonë Rudoka e Madhe, Bistra, etj.

Me mbi 39.000 ha të shpateve të rrëpira veriore të kreshtës kryesore dhe të degëve të saj të Rrafshit të Dukagjinit - të Oshlakut, të Ostrovicës dhe të Koxha Ballkanit - janë shpallur Park nacional me kufij të përkohshëm. Pas hulumtimeve të detajuara dhe valorizimit të zonës, ekspertët propozojnë zgjerimin e kufijve deri në rreth 70.000 ha të këtij masivi unik qendror-ballkanik. Me më shumë se 100 cirqe, të konservuar me gjurmët e lëvizjes së akullit, 2.000 lloje të florës vaskulare, 112 asociacione të cilat përfshijnë breza vegjetativë të ndryshëm, etj.

Me 147 lloje të fluturave, malet e Sharrit janë zona më e pasur e Evropës, ndërsa është strehim edhe për më shumë se 200 lloje zogjsh.

Trashëgimia natyrore dhe kulturore me vlera të larta që e trashëgon Parku nacional Malet e Sharrit e radhit këtë zonë në propozimet për mbrojtje ndërkombëtare, që i janë dërguar organizatës UNESCO (për programin Trashëgimitë natyrore dhe kulturore botërore dhe Njeriu dhe biosfera).

12. PRODUKTET TURISTIKE TE SHARRIT

Sharri është rajon i gjerë i cili përfshinë Kosovën, Shqipërinë dhe Maqedoninë ku ka politika dhe trende të ndryshme të zhvillimit të turizmit. Deri më tani ka patur kooperim në zhvillimin dhe shitjen e produkteve turistike por ende nuk është në nivelin e duhur sikur është rasti në Via Dinarica ku bashkëpunimi i operatorëve turistike ka bërë që të ketë vazhdimësi turistike dhe llojshmëri shërbimesh.

Gjithsesi, në Sharr ka zhvillime në këtë drejtim dhe kjo është kryesisht e fokusuar në turizmin veror gjë që ka filluar të mos jetë e mjaftueshme për shkak të kërkesave të shumta.

Trendet e reja (produktet): Sharri në anën e Kosovës ka faqe veriore dhe mbanë borën për një kohë shumë më të gjatë se në rajonet tjera të Maqedonisë dhe Shqipërisë gjë kjo e cila e ka filluar ti japë formë turizmit dimëror.

Skijimi në pistë: janë disa pika të njohura në Sharr ku skijimi është atraksioni kryesor dhe me shumë kërkesa dhe kjo ka ndikuar që të ketë edhe shërbime të duhura. Brodi, Brezovica dhe Prevala janë destinacine të njohura ku zhvillohet ky lloj turizmi.

Skijimi jashtë pistës dhe Ski Tour: kjo disiplinë është bërë e njohur sidomos në zonën e Vërtopit dhe Majës së Zezë. I gjithë ky kurriz malor pret gjithnjë e më shumë grupe skijimi të cilat ngjiten me ski dhe lëshohen këtyre shpateve. Kjo e ka rritur kërkesën për Guida dhe shërbime tjera dhe kushtimisht edhe akomodimet në hotelet e Prizrenit.

Ecje Dimërore: ecjet me shputa bore por edhe ngjitjet e karakterit alpin kanë kërkesë të re për disa zona të veçanta në Sharr. Deri më tani kjo disiplinë nuk është se ka lënë gjurmë shumë në turizëm por gjithsesi po rritet dhe po ka rezultete të matshme. Për këtë disiplinë mungojnë rekuizitat dhe shërbimet ngase duhet përvojë e guidës dhe matje të sakta të trajektoreve.

Çiklizmi malor: ka grupe të cilat përshkojnë shtigjet e caktuara të cilat janë lokale apo të lidhura me shtetet tjera. Zona e Restelicës paraqet interes ngase si rrafshnaltë lidhet për bukuri me Shqipërinë dhe Maqedoninë nëpërmes Radikës dhe

Koritnikut. Downhill është edhe një tjetër disiplinë e cila ka potencial por duhen poligone dhe shtigje të veçanta. Në të ardhmen mund të jetë produkti shumë i pëlqyer nga turistët për shkak të terrenit të përshtatshëm.

Touret natyrore: pasuria e natyrore e Sharrit po tërheq vizitorë të shumtë të nivelit profesional natyror. Këu hyjnë vëzhguesit e natyrës dhe studiuesit specifik të lëmive natyrore. Këto janë grupe të vogla dhe e vizitojnë Sharrin nëpërmes kontakteve me institucionet dhe shoqatat relevante.

Sporti malor: sky run, mountain run, scouting dhe orineteering janë disa nga disiplinat sportive për të cilat ka interesim kohëve të fundit. Kurrizi i Sharrit ka rritur shtigjesh i cili asnjëherë nuk bjen nën 2200m dhe kjo e bën të përshtatshëm për sportet malore.

Zona Turistike e Kabashit: gjendet në jug të fshatit Korishë dhe paraqet interes për zhvillimin e turizmit etnografik, natyror dhe historik.

Banorët e hershëm kanë origjinë nga Kukësi dhe si fshat është i pasur me pyje, kulla të vjetra dhe gërmadha të një kishe të lashtë paleo-kristiane. Për momentin nuk ka akomodim apo shërbime tjera por as rrjet të shënuar shtigjesh dhe guidë malore. Gjithsesi mbetet resurs dhe fshat i cili pret të eksplorohet dhe të futet në hartën turistike të vendit.

Guri i Dollocit: gjendet në kurrizin e Rustenikut dhe ka pozicion të mirë gjeografik. Mendohet se është mbetje e një fortifikate të ndërtuar gjatë Justiniani të I-rë dhe si e tillë është pikë trigonometrike. I gjithë vargmali përreth këtij lokacioni ka resurse të mira turistike, sidomos për turizmin sportiv por ende nuk ka ndonjë zhvillim përveç restoranteve në fshatin poshtë.

Zona e Rustenikut: ndër parqet e para të mbrojtura në ish YU ka qenë ky rajon i cili kufizohet edhe me komunat e Shtimes, Shtërpces dhe Prizrenit. Ka pyje të pasura dhe botë shtazore të ruajtur mirë, ndërsa rrjeti i shtigjeve ka filluar të marrë formë sepse po ndikohet nga iniciativat e komunave fqinjë.

Zona Turistike e Kabashit: gjendet në jug të fshatit Korishë dhe paraqet interes për zhvillimin e turizmit etnografik, natyror dhe historik. Banorët e hershëm kanë origjinë nga Kukësi dhe si fshat është i pasur me pyje, kulla të vjetra dhe gërmadha të një kishe të lashtë paleo-kristiane. Për momentin nuk ka akomodim apo shërbime tjera por as rrjet të shënuar shtigjesh dhe guidë malore. Gjithsesi mbetet resurs dhe fshat i cili pret të eksplorohet dhe të futet në hartën turistike të vendit.

Guri i Dollocit: gjendet në kurrizin e Rustenikut dhe ka pozicion të mirë gjeografik. Mendohet se është mbetje e një fortifikate të ndërtuar gjatë Justiniani të I-rë dhe si e tillë është pikë trigonometrike. I gjithë vargmali përreth këtij lokacioni ka resurse të mira turistike, sidomos për turizmin sportiv por ende nuk ka ndonjë zhvillim përveç restoranteve në fshatin poshtë.

Zona e Rustenikut: ndër parqet e para të mbrojtura në ish YU ka qenë ky rajon i cili kufizohet edhe me komunat e Shtimes, Shtërpces dhe Prizrenit. Ka pyje të pasura dhe botë shtazore të ruajtur mirë, ndërsa rrjeti i shtigjeve ka filluar të marrë formë sepse po ndikohet nga iniciativat e komunave fqinjë.

14. RAHOVECI

Kanjoni i Drinit: paraqet resurs primar për shkak se në këtë zonë Drini qetësohet dhe krijon kushte për sporte ujore dhe turizëm të vizitave të shkurtëra. Një zonë e tillë është krijuar me projektin e urës së tibetit dhe shtegut të drinit në fshatin Fshaj. Gjithashtu, kjo zonë ka mundësi edhe për sportin e peshkatarisë dhe kanjonimit.

Bjeshka e Zatriqit: vargmal në veri të Rahovecit me potencial të lartë turistik dhe maja të cilat e mbizotërojnë këtë zonë. Janë disa burime karstike të cilat rrjedhin në drejtim të qytetit ndërsa për shkak të gjeologjisë ka edhe shpella të cilat parqesin interes turistik. Majat e njohura të këtij vargmali janë Bajraku dhe Maja e Shkodranit të cilat janë mjaft të njohura dhe lidhen me historinë e Rahovecit. Edhe kjo zonë nuk ka hartë dhe shtigje turistike.

Verëtaria: komponenta më e njohur e Rahovecit dhe resursi kryesor; nga turizmi i verëtarisë kanë përfituar edhe bizneset tjera të perimtarisë dhe kulinarisë sepse shpesh ka ngjarje të ndryshme promovuese. Mbetet ende të zhvillohet si kulturë turistike sepse ka shumë mundësi të zhvillohet turizmi familjar dhe sportiv.

Etno-Kultura: përbërja etnike dhe kulturore e Rahovecit përbën interes për zhvillimin e turizmit kulturor sepse në këtë qytet ka edhe kulinari të kombinuar.

15. MAMUSHA

Komunë e vogël dhe me pozitë jo të favorshme në kuptimin turistik. I vetmi resurs i njohur është "Rruga e Fermave" e cila nënkupton një lloj turizmi të kombinuar të perimtarisë dhe konservimit të perimeve, koncept ky i cili mund të zhvillohet si formë interesi e kulinarisë dhe konservimit.

Struzha: pjesë e Sharrit me karakter tipik bjeshkatar dhe natyror; përfshinë një mori majash dhe liqenesh të cilat i kalojnë 2400m lartësi dhe janë thesar i vërtetë natyror dhe turistik; rrjeti i shtigjeve është mjaft i konsoliduar dhe është duke u rritur ende në drejtim të kufirit.

Prevalla: vend mjaft i njohur për pushim dhe pikënisje e mirë për zhvillimin e tureve të ndryshme duke përfshirë edhe turizmin dimëror. Edhe kjo zonë është pjesë e Sharrit.

Marashi: është emërim për pjesën e vjetër të qytetit dhe grykën e Lumbardhit ku ka mjaft monumente kulturore dhe biznese turistike. Kryesisht zhvillohet turizmi i vikendit por kohëve të fundit edhe ai i vizitave masive nga vendet fqinje (blic grupe).

Kanjoni i Lumbardhit: përfshinë një zonë të pasur me resurse turistike, duke përfshirë edhe turizmin e aventurës. Në këtë zonë gjendet edhe vargmali i Tumbës ku ka edhe mjaft shpella me potencial por edhe mundësi për turizmin pastoral. E gjithë zona ka fshatra të vjetër të cilët kanë filluar të zhvillohen ngadalë turistikisht sepse janë pikënisje e mirë për toure drejt Sharrit.

Nasheci: është grykëderdhja e Drinit në liqenin e Kukësit dhe krijon një resor të bukur për zhvillimin e turizmit. Ka qenë zonë e njohur edhe më parë dhe sigurisht pas një kohe do ta ketë vendin e vet në hartën turistike të Kosovës.

Pashtriku: është zonë malore dhe markante dhe zona jugore e Pashtrikut lidhet me Prizren. Ende nuk ka rrjet të zhvilluar shtigjesh por kryesisht vizitohet nga turistë vendor.

Etno-Kultura: turizmi kulturor në Prizren është mjaft i njohur dhe përbën mundësi të mirë për zgjerim. Ky koncept është duke e ndihmuar edhe turizmin malor sepse qasja në Sharr është e lehtë.

Kjo komunë konsiderohet si komuna më e pazhvilluar Kosovë, por megjithatë kjo komunë ka potenciale natyrore për të zhvilluar turizmin. Kjo komunë karakterizohet me potencial për zhvillimin e turizmit përgjatë lumit Mirusha edhe pse nuk ka zhvilluar infrastrukturë, ky vend është një atraksion dhe ka potencial për t'u zhvilluar si destinacion turistik.

Atraksionet dhe potencialet turistike përgjatë kësaj zone përfshijnë këto lokacione: Pishina e Banjës në fshatin Banjë; Shpella e Flladit, në fshatin Panorc; Ujëvarat e Mirushës, në fshatin Llapqevë; Ura e Rabaxhive, në fshatin Bubël; Malet e Berishës, në fshatin Berishë; Varrezat e Dëshmorëve, në Malishevë dhe në fshatin Kleçkë, etj.

Në fshatin Banjë, mendohet që në të ardhmen e afërt ky vend të shndërrohet në një vend turistik për rekreacion, sport dhe rehabilitim vend turistik për rekreacion, sport dhe rehabilitim pasi që gjendet burimi i ujit termal me kapacitet 250-300 l/sec. Mbi këtë burim të ujit është ngritur pishina me sipërfaqe 2000 m², e cila çdo sezon vere është në shfrytëzim për freskim dhe organizim të garave të notit nga të interesuarit.

Pishina ka vizitorë të shumtë, jo vetëm të komunës por edhe nga mbarë vendi. Uji i kësaj pishine ofron edhe mundësi shërimi nga një numër i caktuar i sëmundjeve të lëkurës.

Malet e Berishës janë atraksion tjetër turistik, jo vetëm për banorët e komunës. Me llojlojshmërinë e florës dhe faunës së tyre, tërheqin shumë vizitorë për piknik malor. Vende interesante për tu vizituar.

Koritniku: zonë me potencial të turizmit malor dhe me lidhje të mira me parkun kombëtar Korab-Koritnik ku lidhet edhe Kukësi, Prizreni dhe Shishtavec.

Opoja: zonë pastorale dhe me lidhje të mira me gjeografike me Sharrin. Janë disa fshatra ku ka filluar të ketë lëvizje në kuptimin turistik.

Brodi: zonë e njohur për turizmin veror dhe dimëror ku ka edhe akomodim. Janë disa pika të njohura që njihen pak nga turistët e ku hyjnë Vrella Alpine e Çelepinos dhe Burimet e Vracës. Gjithashtu ka resurse të pamatshme natyrore si majat e Vracave, Rudokës, Çelepimno dhe Bakardani me majat përreth. Kjo zonë do të zhvillohet tutje dhe do të ndikojë mjaft edhe në zonat tjera.

Restelica: gjendet në jug të vendit dhe deri më tani nuk e ka arritur rolin e vet në turizëm. Në pjesën jugore të Restelicës gjenden kullosat alpine më të mëdha në Ballkan si dhe burimet e Radikës. Ka mundësi të pafundme për turizmin veror dhe dimëror.

Nasheci: është grykëderdhja e Drinit në liqenin e Kukësit dhe krijon një resor të bukur për zhvillimin e turizmit. Ka qenë zonë e njohur edhe më parë dhe sigurisht pas një kohe do ta ketë vendin e vet në hartën turistike të Kosovës.

Pashtriku: është zonë malore dhe markante dhe zona jugore e Pashtrikut lidhet me Prizren. Ende nuk ka rrjet të zhvilluar shtigjesh por kryesisht vizitohet nga turistë vendor.

Etno-Kultura: turizmi kulturor në Prizren është mjaft i njohur dhe përbën mundësi të mirë për zgjerim. Ky koncept është duke e ndihmuar edhe turizmin malor sepse qasja në Sharr është e lehtë.

18. ZHVILLIMI I PRODUKTEVE TE REJA TURISTIKE

Zhvillimi i këtyre produkteve me karakter unik dhe inovativ bazohet në praktika të mira nga vendet e zhvilluara dhe njëherit kanë treguar qëndrueshmëri të lartë ekonomike dhe kanë dhënë rezultate të mira duke siguruar të hyra dhe janë të realizueshme. Këto produkte janë kategorizuara si produkte turistike në natyrë dhe kanë dhënë profit.

Disa rekomandime lidhur me Zhvillimin e Produkteve Turistike me karakter unik dhe inovativ për të përmirësuar vëllimin e turistëve:

- Parku i lojërave (Adventure Park);
- Akomodim ndryshe nga ai i zakonshmi (anglisht tree houses (shtëpi mbi drunj)), open sky (fjetje nën qiell të hapur);
- Aktivitete në drunjë (vendosja e rrjeteve etj);
- Zip line apo Zip Coaster (me kabinë);
- Via Ferrata – ngjitje në shkembinjë;
- Ura Tibetiane;
- Rëshqitje në pistë;
- Etj.

Në këtë vegëz mund të shihni katalogun për zhvillimin e produkteve të reja turistike të realizuara nga programi PPSE në vitin 2018.

https://ppse-kosovo.org/file/repository/SWISS_PUBLIKIM_ENG_WEB.pdf

19. KONKLuzionet, Vështrimet dhe Rekomandimet

Bazuar në analizën e situatës dhe konsultimet me palët pjesëmarrëse në hulumtim, pjesa në vazhdim përmbledhë çështjet kryesore në lidhje me hulumtimin e turizmit rural.

Si konkluzion, turizmi rural në rajonin jugor të Kosovës është në fazën e hershme të zhvillimit por ka potencial të madh për tu zhvilluar bazuar në pasuritë të burimeve natyrore dhe atraksioneve të trashëgimisë kulturore duke krijuar punësim dhe përfshirje sociale.

Politikat qeveritare duhet të përqëndrohen fillimisht në përmirësimin e infrastrukturës duke e ruajtur natyrën dhe trashëgiminë kulturore dhe financimin e një koncepti më të zgjeruar për zhvillimin e produkteve të reja turistike me karakter unik dhe inovativ si dhe për të mbështetur agro-turizmin dhe eko-turizmin;

Është me rëndësi të madhe që ministritë përkatëse të përpilojnë një planifikim të integruar dhe investime kapitale për zhvillim të qëndrueshëm duke përfshirë edhe koordinimin e politikave në mes të sektorit të turizmit dhe bujqësisë për të siguruar koordinim në nivel kombëtar që parashihen të jenë esenciale për zhvillim.

Rekomandohet më tej që autoritetet lokale dhe qendrore duhet të punojnë më për së afërmi me komunitetin rural, operatorët turistik, ofruesit tjerë të shërbimeve në turizëm (bujtina, gastronomia) fermerët dhe kooperativat për të organizuar zingjirin e furnizimit për përkrahjen e biznesit të agro-turizmit siç janë veprimtaritë e akomodimit, aktivitetet në natyrë, aktivitetet kulturore, shërbimet turistike, përkrahja me grante dhe asistencë tjetër teknike duke përfshirë edhe qasjen në institucionet e mikro-kredive.

Përmirësimi i legjisllacionit dhe harmonizimi i tij me standardet evropiane si dhe zhvillimi i politikës fiskale stimuluese si dhe përmirësimi i rregulloreve ligjore që rregullojnë biznesin e turizmit duke zhvilluar një kornizë ligjore cilësore dhe e harmonizuar për menaxhim të suksesshëm të zhvillimit të turizmit, siç është Ligji për Turizmin, pastaj një tërësi ligjesh në fushën e mbrojtjes së mjedisit, zgjidhjet e të cilave duhet të sigurojnë edhe më vonë mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e zonave turistike, Ligji për Ilixhat, Ligji për Parqet Kombëtare, Ligji për Planifikimin dhe Ndërtimin, etj.

Ngritja e kapaciteteve ekzistuese ka rol të veçantë në zhvillimin e të dy sektorëve. Ndërtimi i kapaciteteve institucionale dhe ngritja e aftësive të tyre profesionale përmes trajnimeve edukative do të sigurojnë bazë të qëndrueshme për zhvillimet e qëndrueshme në të ardhmen për ngritjen e kualitetit të shërbimeve.

Marketingu duhet të zhvillohet në përputhje me teknologjinë e re dhe të përfshijë portale në Internet të cilat do të sigurojnë informata për vizitorët potencial në zonat agro-turistike, me informata specifike mbi produktet agro-turistike, burimet natyrore, trashëgiminë kulturore dhe ofertat për vizitorët.

Partneritetet publiko-private janë një mori iniciativash të përbashkëta të sektorëve publik dhe privat përmes së cilave secili entitet ndan dhe përdor burimet dhe njohuritë e tij për të plotësuar nevojat e popullatës dhe konceptet e tilla do të vazhdojnë për të integruar zhvillimin e bujqësisë duke përfshirë edhe zhvillimin e agro-turizmit në regjionin jugor.

Përmirësimi i kushteve të përgjithshme të biznesit mund të bëhet përmes ndërtimit të infrastrukturës komunale, p.sh. rrugët publike, promovimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të marketingut si dhe sigurimit të makinerisë dhe paisjeve për veprimtaritë në ferma.

Avancimi i bujqësisë dhe i përpunuesve të prodhimeve bujqësore do të mundësojë qasjen në tregjet ndërkombëtare dhe në proceset e reja teknologjike. Kjo përfshinë transferimin e njohurive dhe përdorimin e teknologjive të reja në bujqësi dhe në proceset e përpunimit të produkteve bujqësore.

Përmirësimi i kualitetit të jetesës për popullatën e viseve rurale mund të bëhet përmes lehtësimit në qasje më të mirë në shërbime publike përfshirë edhe sistemin e kujdesit shëndetësor, sigurimin e përkrahjes arsimore për popullatën rurale për ngritjen e aftësive të tyre për nevojat e tregut.

Përdorimi më i mirë i burimeve komunitare do të kontribuojë në diversifikimin e ekonomisë rurale dhe punësimin e grave dhe grupeve tjera të ndjeshme.

Sa i përket politikave, autoritetet përkatëse do të hartojnë politika efektive siç janë dialogjet në nivelin komunal dhe qendror që do të stimulojnë dhe kontribuojnë në zhvillimin e turizmit rural dhe agro-turizmit përmes promovimit të partneriteteve publiko-private, lëshimit të tokave me qera, zgjerimin e skemës kreditore rurale dhe krijimin e një fondi/shume për përkrahjen e agro-turizmit si një nën-sektor.

Masat në vazhdim janë cilësuar si të nevojshme për ti ngritur kapacitet ekzistuese të paraqitura si në vijim:

- Personeli përkatës komunal që punojnë në sektorët e bujqësisë, turizmit dhe agro-turizmit;
- Fermerët individual dhe shoqatat e fermerëve, shoqatat e agro-biznesit;
- Sektori i hotelierisë (hotelet, qendrat turistike, restorantet);
- Kompanitë për përpunimin e produkteve bujqësore;
- Organizatat e shoqërisë civile që punojnë në agro-turizëm dhe turizëm;
- Institucionet dhe grupet tjera të interesit.

Punësimi

Zhvillimi i turizmit rural krijon vende të reja të punës dhe mundësi të reja biznesi të tilla si hotelet dhe shërbimet e ushqimit, por edhe në shërbimet e mikpritjes dhe veprimtaritë rekreative. Poashtu, turizmi rural rrit mundësitë e karrierës për të rinjtë me mundësi për trajnim dhe përfshirje të drejtpërdrejtë në drejtimin e bizneseve të turizmit.

Punësimi në zona rurale duhet promovohet përmes marrjes së masave specifike të tilla siç janë theksuar më poshtë: trajnimi për zhvillim të aftësive; trajnime tjera profesionale; mbështetja e bizneseve fillestare si dhe pjesëmarrje aktive në panairët e punës dhe karrierës. Kjo duhet bërë duke i kushtuar vëmendje të veçantë talentit, aftësive dhe kompetencave individuale si faktorët kryesorë shtytës për krijimin e vendeve të punës.

Zhvillimi i Bjeshkëve të Sharrit si projekt pilot i agro-turizmit përfaqëson një potencial të madh me anë të burimeve natyrore të tyre për zhvillimin e turizmit rural duke përfshirë edhe përpunimin e ushqimit tradicional siç është djathi, bërja e verërave, mjaltit, gjemit, lëngjeve, frutave të egra, ecjet në natyrë, qiklizmi dhe ecjet sportive.

Në mënyrë që të perkrahet zhvillimi i Bjeshkëve të Sharrit si projekt agro-turistik, nevojiten investime për zgjerimin e mjeteve dhe objekteve turistike si dhe sigurimi i përkrahjes së integruar për fermerët vendor për zhvillimin e tyre. Për më tepër duhet të bëhen investime në infrastrukturën rurale duke përfshirë riparimin e rrugëve, krijimin e lidhjeve funksionale transportuese, menaxhimin e hudhjes së mbeturinave, sistemet e ujitjes dhe energjisë ripërtrirëse të cilat janë kritike për zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen gjersa sektori i hotelierisë dhe marketingu i duhur gjithashtu duhet të zhvillohen.

Hapat që duhen ndërmarrë në të ardhmen sipas këtij hulumtimi do të përfshijnë një plan zhvillimor të mëtejme për kompletimin e hartimit të procesit të strategjisë.

- Ndarja e këtij raporti hulumtues draft me palët pjemarrëse në interes të rajonit jugor duke përfshirë departamente përkatëse komunale dhe të kërkohen komentet e tyre dhe të dhënat e tyre për procesin për të siguruar një proces konsultativ;
- Organizimi i një punëtorie gjatë së cilës do të prezantohet dhe aprovohet raporti hulumtues final;
- Pas aprovimit, raporti hulumtues do të publikohet për përdorim të grupeve tjera në interes.

Pas aprovimit, hapi tjetër për t'u ndërmarrur në proces do të jetë atëherë kur Organizata EC Ma Ndryshe do të organizojë një takim me institucionet përkatëse dhe me palët në interes në mënyrë që të takohen dhe të hartojnë plane për zhvillimin e strategjisë gjithëpërfshirëse rajonale bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e hulumtimit.

Në mënyrë të ngjajshme, hartimi i strategjisë rajonale do të bëhet me proces pjemarrës me komunat dhe palët tjera përkatëse në interes.

Hartimi i strategjisë rajonale për turizmin rural në rajonin jugor përveq tjerave do të zhvillojë një strategji të zbatueshme me objektiva zhvillimore duke përdorur një qasje të orientuar në rezultate.

Një propozim për zhvillimin e parteriteteve publiko-private bazuar në qasjet e testuara nga projektet ndërkombëtare dhe një program për trajnime edukative profesionale i cili do të bazohet nga një vlerësim i thukët i kapaciteteve të secilës palë në interes.

Strategjia regjionale mund të identifikojë masa shtesë të cilat do të kontribuojnë direkt në zhvillimin e turizmit rural dhe një propozimi më të detajizuar në themelimin e qendrave informuese dhe koordinative të cilat do t'a promovojnë turizmin rural në nivel rajonal.

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore. Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm.

Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe
3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen.

EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.